

STRESI

1. Një pacient është diagnostikuar me një sëmundje terminale. Ai thotë: “E çfarë të bëj tani, ndihem totalisht pa shpresë?” Përgjigjja më e mirë infermierore do të ishte:
 - a) “hë mo dhe ti se nuk je pa shpresë”
 - b) “mos ji kaq i depresuar”
 - c) “E kuptoj që duhet të jetë e vështirë që të mendosh që nuk ka shpresë, por ne jemi këtu për ju”
2. Infermierja observon se një klient i shtruar në spital i sapo diagnostikuar me sëmundje zemre po qan dhe nuk lëviz nga dhoma. Kjo sjellje e identifikuar nga infermierja gjatë vlerësimit janë shenja e cilës sjellje?
 - a) Sjellje e papërshtatshme
 - b) Sjellje psikotike
 - c) Sjellje adaptimi me sëmundjen
3. Një pacient që ka 5 ditë që është shtruar në spital thërret me zë të lartë: “më sill ilaçin e dhimbjes tani.” Infermierja mendon se sjellja e pacientit është një:
 - a) Përgjigje e zakonshme
 - b) Një përgjigje e pa përshtatshme
 - c) Një problem
4. Kur prek trupin e pacientit për të ndjerë nxehtësinë infermieri duhet të përdorë cilën pjesë të dorës?
 - a) Majat e gishtave
 - b) Mollzat e gishtave
 - c) Kurrizin e dorës
5. Për të vlerësuar suksesin e spirometrit incentive infermieri përdor puls të oksimetër për të monitoruar:
 - a) Saturimin e oksigjenit

- b) Nivelin e hemoglobinës
 - c) Nivelin e dioksidit të karbonit
6. Rezultatet e analizës laboratorike të gjakut të një pacienti janë: numri i rruazave të bardha (ËBC)1,000 μ l, hemoglobin 14 g/dl, hematokriti 42%. Cili do të ishte qëllimi më i rëndësishëm i kujdesit për këtë pacient?
- a) Sigurimi i balancës së lëngjeve
 - b) Parandalimi i infeksionit
 - c) Promovimi i pushimit
7. Një infermiere po vlerëson një pacient për faktorët e lidhur me stilin e jetës që mund të ndihkojnë përballim normal. Cili faktor jetësor duhet marrë në konsideratë nga infermierja?
- a) Dieta e papërshtatshme
 - b) Divorc
 - c) Ngritjen në detyre
8. Një infermiere po kujdeset për një pacient i cili ka amputuar pjesën nga gjuri e poshtw. Ai refuzon të shikojë këmbën e prerë. Kur infermieri përpiqet të flasë me pacientin rreth ndërhyrjes ai thotë se nuk dëshiron të flasë për këtë. Po ashtu pacienti refuzon vizitat e familjarëve të tij. Cila diagnozë infermierore përshkruan më së miri këtë problemin e pacientit:
- a) Humbje e shpresës
 - b) Pafuqishmëri
 - c) Shqetësim mbi imazhin trupor
9. Gjatë pranimit në spital infermieri vëren se pacienti geriartrik duket konfuz. Cili mund të jetë shkaku i konfuzionit të pacientit:
- a) Depresioni
 - b) Ndryshime në memorjen afat-gjatë
 - c) Stress nga një situatë jofamiljare

10. Cili nga faktorët e mëposhtëm do të ketë influencën më të madhe në pasojat e një situatë krize?

- a) Moshë
- b) Aftësitë e mëparshme të përballimit
- c) Mendimi për veten

11. Kur infermieri hyn në dhomë pacienti i drejtohet: “kam një 20 minuta që po i bie ziles. Më ka ardhur në majë të hundës ky vend dhe stafi i këtushëm.”. Përgjigja më e mirë infermierore do të jetë:

- a) “Më vjen keq, por isha e zënë me një pacienti tjetër”
- b) “Ju dukeni i mërziur këtë mëngjez”
- c) “Keni pasur dritën ndezur për 20 min?”

12. Një pacient me një plagë abdominale të infektuar duhet të vendoset në izolim strikt për 10 ditë. Për të plotësuar nevojat emocionale të pacientit infermieri do t'i:

- a) Thotë pacientit dhe anëtarit të familjes se ata nuk mund ta vizitojnë për 10 ditë por mund ta marrin në telefon në çdo kohë
- b) Shpjegojë me kujdes se lëvizjet e pacientit duhet të jenë të kufizuara gjatë kohës së izolimit
- c) Përshkruajë arsyen e izolimit dhe se si do të procedohet dhe do të jepet siguria

13. Infermieri po vlerëson pacientin për faktorët e lidhur me stilin e jetës që do të ndikojnë në përballimin normal. Cili do të jetë faktori që do të konsiderojë infermieri:

- a) Dieta e papërshtatshme
- b) Divoci
- c) Adotimi i një fëmije

14. Një pacient tregon shenja të rritjes së ankthit. Cila përgjigje infermierore ka më shumë mundësi që të qetësojë ankthin e pacientit?

- a) “Mos u shqetëso. Cdo gjë do shkojë mirë”
- b) “Lexo këtë broshurë dhe më pas pyet çfarë të shqetëson”

c) “Pse nuk dëgjon radion”

15. Cila thënie tregon se infermierja e kupton koceptin lidhur me vetevrasjen?

- a. Kur një person bisedon rreth kërcënimit suicide, e vetmja gjë që kërkon është vëmëndja e familjarëve dhe miqve
- b. Diskutimi mbi suicide me një pacient nuk është i dëmshëm
- c. Personat me depresion janë të vetmit që kryejnë suicide

16. Një pacient me ulcer peptike thotë që stresi shpesh e acaron problemin e tij. Infermierja percakton se cili nga informacionet e pacientit ka më shumë mundësi të jetë përgjegjës për acarimin?

- a) Gjumi 8-10 orë në ditë
- b) Ushqyerje 5 herë në ditë me porcione të vogla
- c) Nevoja e here pas hershme për të punuar 2 turne pa lajmëruar

17. Një pacient u shtrua në spital me diagnose hepatit viral. Për të diktuar ndonjë vështrësi të përballimit të sëmundjes infermieri duhet ti drejtoi pacientit cilën pyetje?

- a) “A ke humbur në peshë?”
- b) “A të pëlqen kur të vijnë dhe te vizitojnë?”
- c) “A ke ethe?”

18. Një klient ka kryer ndërhyrje kirurgjikale për heqjen e kataraktës por nuk ka vendosur implant intraocular. Pacienti duket i shqetësuar sepse vizioni është i turbullt. Cila përqasje e ndërmare nga infermieri do të sigurojë mbështetje emocionale për klientin?

- a) Eksploro domethënien e humbjes përmanente të vizionit
- b) Shpjego se vizioni do të përmirësohet me vendosjen e lentes aphakice
- c) Siguro klientin që do të marrë përfitime nga paaftësia

19. Një mjek sapo i tha një pacienteje që ka kancer të gjoksit. Pacienta thotë: “a do të thotë kjo që unë do të vdes?” infermieri e interpreton reagimin e pacientes si:

- a) Ankth
- b) Frikë
- c) Inat

20. Një infermiere po punon me një pacient që sapo u diagnostikua me insuficiencë renale kronike dhe u planifikua për hemodializë. Klienti thotë: “kjo është e pamundur. Si unë mund të mendoj që të jetoj një jetë normale përsëri në rast se duhet të bëj këtë?” Infermieri vlerëson se pacienti po shfaq:

- a) Tërheqje
- b) Depression
- c) Inat

